



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Vlerësimit Institucional të
Universitetit të Tiranës**

Prill 2017

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM :


1. Dr. Neil Casey Kryetar



2. Z. Grant Horsburgh Anëtar



3. Z. Kevin Kendall Anëtar



4. Znj. Penny Renwick Anëtare



5. Profesor Thoma Korini Anëtar

6. Dr. Gjergj Thoma Anëtar



Datë: Prill 2017

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raporti i përmbledhur.....	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Gjykim i përmbledhur	7
Raporti i detajuar.....	8
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	8
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	12
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	16
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mesimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	20
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	24

Rreth këtij vlerësimi

Synimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se sa i përmbush çdo IAL Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është një proces i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që janë të specializuar në të njëjtën fushë, dhe çdo grup vlerësimi përbëhet nga një ndërthurje e vlerësuesve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA dhe të vlerësuesve shqiptarë të caktuar nga APAAL. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një vlerësues i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'i ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet për përmirësime (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe të mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë përmbledhur nën pesë tematika me këto Fushat Vlerësimi: Organizimi dhe Drejtimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, të Nxëniet, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet mbi veprimet ndërmarra dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, ndjekur nga një gjykim lidhur me shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të. Gjykimet që mund të bëjnë vlerësuesit janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur në mënyrë të konsiderueshme; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në përfundim, vlerësuesit e përmbyllin punën e tyre me rekomandimin e një gjykimi përmbledhës, që i dorëzohet Këshillit të Akreditimit të APAAL. Ky gjykim i përgjithshëm jepet sipas shkallës së mëposhtme të vlerësimit me katër nivele:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur**

Në kuadrin e procesit të përpilimit të raportit, QAA ka siguruar ekspertë mbështetës për grupin e vlerësimit duke siguruar që grupi t'i mbështesë Gjetje në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Tiranës (Universiteti) është institucioni më i madh i arsimit të lartë në vend. Ai u themelua në vitin 1957 me emrin Universiteti Shtetëror i Tiranës, duke përmbledhur gjashtë institucione të arsimit të lartë që vepronin në Tiranë: Institutin e Shkencës, Institutin Pedagogjik, Institutin Politeknik, Institutin e Mjekësisë, Institutin Bujqësor dhe Institutin e Ekonomisë dhe Drejtësisë.

Universiteti ka gjashtë fakultete: Fakultetin e Drejtësisë, Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Fakultetin e Shkencave Natyrore, Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Universiteti ka gjithashtu edhe dy institute, atë të Fizikës Bërthamore të Aplikuar dhe atë të Studimeve Evropiane, si dhe filiale në Sarandë dhe në Kukës [RVV fq. 10-11; GID]

Universiteti ofron programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë dhe pothuajse të gjitha këto programe ofrohen në shqip. Nga 174 programe studimi gjithsej, 36 janë diploma në bachelor, 100 janë diploma në master dhe 28 janë programe doktorature. Në vitin akademik 2016-17, Universiteti pranoi afërsisht 15.500 studentë në programet e ciklit të parë dhe më shumë se 7.600 studentë në ciklin e dytë. Numri i stafit akademik me kohë të plotë në Universiteti arrin 800, ndërsa me kohë të pjesshme 1.100; numri i stafit mbështetës arrin më shumë se 300. [GID]

Universiteti i është përkushtuar forcimit të njohjes së tij ndërkombëtare dhe ka qenë një institucion ndërkombëtar partner në një sërë programesh të Bashkimit Evropian dhe programesh të tjera bashkëpunimi. Ai ka nënshkruar gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi me një sërë universitetesh evropiane dhe botërore me qëllim përfitimet nga studentët dhe stafi.

Universiteti i Tiranës po aplikon për herë të parë për akreditim te Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Raporti i përmbledhur

Një ekip i Universitetit, që përfshinte përfaqësuesit të stafit akademik dhe atij mbështetës nga secili prej të gjashtë fakulteteve, hartoi një Raport Vlerësimi të Brendshëm(RVV). Një draft i këtij raporti iu shpërnda stafit të Universitetit përpara se të përfundohej dhe të miratohej nga Rektori.

Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje fillestare me fakte mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit. RVV u strukturua sipas Fushave të Vlerësimit dhe Standardeve Shtetërore të Cilësisë. Megjithatë, kishte hapësirë për të përmirësuar referencat dhe ofrimin e dokumentacionit. Pjesa më e madhe e fakteve ishin të përgatitura në gjuhën shqipe, por me kërkesë të grupit të vlerësimit, këto materiale u plotësuan me dokumentacion shtesë përpara dhe gjatë vizitës, shumica prej të cilave u përkthyen në anglisht. Dokumentacioni e ndihmoi grupin që të familjarizohej me aspekte të strukturës, politikave, procedurave të drejtimit dhe me natyrën e veprimtarive të mësimdhënies dhe kërkimit të ndërmarrë nga Universiteti. Faktet e para të shqyrtuara përfshinin Rregulloret e Universitetit, të dhënat për arritjet e stafit dhe studentëve, dokumentacion të ndryshëm procedural, një sërë marrëveshjesh me institucione jashtë Universitetit dhe shembuj të informacioneve për programet.

Vizita u krye përgjatë tre ditëve. Grupi vlerësimit ishte i përbërë nga katër vlerësues të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe nga dy anëtarë me përvojë në arsimin e lartë, nga stafi i Institucioneve Shqiptare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Administratorë të Vlerësimit dhe mbajtës shënimesh të siguruar nga APAAL, agjencia përgjegjëse për vlerësimet e arsimit të lartë në Shqipëri. Gjatë tre ditëve të vizitës së vlerësimit u organizuan një sërë takimesh, që i mundësuan grupit të vlerësimit të kuptojë më qartë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e stafit dhe studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektoren, drejtuesit e lartë, studentë nga të tre ciklet e studimeve, lektorë, staf administrativ dhe mbështetës, dhe punëdhënës vendorë. Gjatë takimeve u morën shënime. Si pjesë të vizitës në ambientet e Universitetit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi dy fakultete, bibliotekat, hapësirat e mësimdhënies dhe laboratorët e tyre. Pas vlerësimit të të gjitha fakteve të vëna në dispozicion, grupi arriti përfundimet e renditura në vijim.

Universiteti i përmbush pjesërisht standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një sërë dobësish dhe bëri disa rekomandime. Grupi identifikoi si dobësi mungesën e një deklaratë të qartë të misionit të Universitetit dhe objektivave të tij në Statutin e vitit 2009, si dhe vonesën për hartimin e një Statuti të përditësuar, që merr në konsideratë Ligjin për arsimin e lartë, të vitit 2015. Ai rekomandoi që Universiteti të përditësojë dhe përmirësojë Statutin e tij, duke përfshirë një deklaratë të qartë të misionit dhe objektivave të tij. Duke qenë se nuk kishte një strategji zhvillimi aktuale, të përditësuar dhe të plotë, grupi rekomandoi që Universiteti të hartojë dhe të zbatojë një strategji zhvillimi, që përfshin misionin dhe qëllimin e saj, dhe që përcakton objektiva të përshtatshme. Duke qenë se raporti vjetor për vitin 2016 nuk ishte dorëzuar në Ministri, grupi rekomandoi që Universiteti të sigurohet që raporti vjetor t'i dorëzohet Ministrisë brenda afateve të përshtatshme, në përputhje me pritshmëritë ligjore dhe statutore. Së fundmi, grupi rekomandoi që Universiteti të sigurohet që studimi i tregut të ndërmerret në nivel qendror, në mënyrë që të ushqejë strategjinë e tij të zhvillimit, misionin dhe qëllimin. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi shembuj të praktikës së mirë, ose konfirmime për veprime në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Universiteti i përmbush në mënyrë të konsiderueshme standardet për Burimet. Përgjegjësitë për burimet janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një sërë dobësish dhe dha rekomandimet përkatëse. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandoi që Universiteti duhet t'i trajtojë

dobësitë e identifikuar, duke zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të dokumentuar, për vlerësimin periodik të performancës dhe aftësive të stafit. Gjithashtu, grupi rekomandoi që dobësitë duhet të korrigojen, duke përditësuar dhe duke përmirësuar faqen e internetit, për të siguruar një platformë të qëndrueshme, dy-gjuhëshe dhe të përshtatshme për qëllimin, që përmbush nevojat e të gjitha palëve të interesit. Në kuadrin e një dobësie të identifikuar dhe duke pasur parasysh trysninë e vazhdueshme për mjedisin dhe infrastrukturën për performancë akademike dhe shkencore, grupi rekomandoi që Universiteti të ndërmarrë hapa për sigurimin e burimeve të mjaftueshme, për një mjedis dhe infrastrukturë të përshtatshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi shembuj të praktikës së mirë ose konfirmime për veprime në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Universiteti përmbush në mënyrë të konsiderueshëm standardet për Kurrikulën. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandoi që Universiteti të përmirësojë dobësitë, duke shqyrtuar bazën e të dhënave të programeve të studimit, për t'u siguruar që ajo është aktuale, e saktë dhe në përputhje me kërkesat ligjore. Grupi gjithashtu rekomandoi që Universiteti të trajtojë edhe dobësinë e mobilitetit të ulët të studentëve, duke hartuar dhe zbatuar qasje strategjike për rritjen e mobilitetit të studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi shembuj të praktikës së mirë apo konfirmime për veprime në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Universiteti plotëson pjesërisht standardet për Mësimdhënien, të Nxënit, Vlerësimin dhe Kërkimin. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi disa dobësi dhe dha rekomandimet përkatëse. Në lidhje me trajtimin e dobësisë së mungesës së provave të qarta dhe të dokumentuara të një sistemi moderimi, grupi rekomandoi që Universiteti të sigurojë një politikë dhe procedurë të qartë dhe të dokumentuar, që përcakton qasjen institucionale ndaj vlerësimit. Rekomandohet gjithashtu që Universiteti të trajtojë dobësitë, duke hartuar dhe bërë publike një politikë formale për plagjiaturën dhe shkeljet e tjera akademike. Nevoja për një politikë të qartë dhe të dokumentuar të Universitetit, për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, u korrigjua dhe u përcaktua si dobësi, dhe sollli rekomandimin për qartësimin dhe bërjen publike të qasjes së Universitetit, për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Së fundmi, u rekomandua që Universiteti të korrigojë dobësitë, duke hartuar dhe zbatuar një strategji formale për kërkimin, duke udhëhequr prioritetet institucionale në lidhje me të. Grupi nuk identifikoi praktika të mira apo konfirmime për veprime në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Universiteti i përmbush në mënyrë të konsiderueshme standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si dobësi ofrimin e teksteve shkollore dhe materialeve në internet, si edhe aksesin e pamjaftueshëm të studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandoi që Universiteti duhet të veprojë për të përmirësuar ofrimin dhe aksesin e librave në biblioteka dhe të burimeve në internet. Grupi rekomandoi gjithashtu hartimin e një politike formale për shëndetin, duke përcaktuar disa procedura për vlerësimin e efikasitetit të saj, për të trajtuar dobësinë e mungesës së një politike të qartë për ndjekjen e politikave parandaluese dhe kuruese, për përmirësimin e shëndetit të studentëve. Një tjetër dobësi e identifikuar lidhet me mos ruajtjen e të dhënave statistikore nga ana e Universitetit për përqindjen e punësimit të të diplomuarve të tij, dhe grupi rekomandoi që Universiteti të krijojë një strukturë dhe të hartojë procedura të posaçme, për mbledhjen dhe ruajtjen e këtyre të dhënave. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi hapat e ndërmarrë nga Universiteti për përmirësimin e mbështetjes për punësim, përmes krijimit të Qendrave të Karrierës. Nuk u identifikuan praktika të mira në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Standardet janë përmbushur kryesisht në tre Fusha Vlerësimi dhe janë përmbushur pjesërisht në dy të tjera. Si përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon se Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Mungesën e një deklaratë të qartë të misionit dhe synimeve të Universitetit në Statutin e miratuar të vitit 2009 dhe vonesën në hartimin e Statutit të përditësuar që merr në konsideratë ligjin për arsimin e lartë të vitit 2015 (pika 1.1; **Kapitulli III, Standardi I.1**).
- Mungesën e një strategjie aktuale, të përditësuar dhe të plotë zhvillimi (pika 1.5; **Kapitulli III, Standardi I.5**).
- Një raport vjetor nuk i ishte dorëzuar Ministrisë në vitin 2016 pika 1.6; **Kapitulli III, Standardi I.6**).
- Mungesën e studimit të tregun në nivel institucional për të orientuar misionin dhe qëllimin e Universitetit (pika 1.8; **Kapitulli III, Standardi III.1**).
- Mungesën e provave për një qasje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të dokumentuar ndaj vlerësimit periodik të performancës dhe aftësive të stafit (pika 2.4; **Kapitulli III, Standardi IV.3**).
- Përmbajtjen jo të qëndrueshme, formatin dhe stilin e faqes së internetit, zhvillimin e pamjaftueshëm të seksioneve kyçe të saj, dhe mbështetjen e saj vetëm në gjuhën shqipe (pika 2.7; **Kapitulli III, Standardi VII.1; Kapitulli III, Standardi VII.2**).
- Trysninë e vazhdueshme në mjedis dhe infrastrukturë për performancën akademike dhe shkencore (pika 2.9; **Kapitulli III, Standardi V.1**).
- Baza e të dhënave të programeve të studimit nuk është e përditësuar, përmban programe të dyzuara dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor (pika 3.1; **Kapitulli I, Standardi I.1**).
- Mobilitetin e pakët të studentëve në programe evropiane (pika 3.10; **Kapitulli I, Standardi I.10**).
- Mungesën e provave të qarta dhe të dokumentuara të një sistemi moderimi, që do t'i siguronte palët e interesit që proceset e vlerësimit janë të vlefshme, të sakta dhe të drejta (pika 4.2; **Kapitulli I, Standardi II.2**).
- Mungesën e një politike formale për plagjiaturën dhe shkeljeve të tjera akademike (pika 4.3; **Kapitulli I, Standardi II.2**).
- Mungesën e një politike të qartë dhe të dokumentuar të Universitetit për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit (pika 4.4; **Kapitulli I, Standardi II.3**).
- Mungesën e një strategjie formale për kërkimin për të orientuar prioritetet (pika 4.8; **Kapitulli I, Standardi I.4; Kapitulli I, Standardi I.5**).
- Ofrimin dhe aksesin e pamjaftueshëm të teksteve shkollore dhe materialeve në internet (pika 5.5; **Kapitulli I, Standardi III.5**).
- Mungesën e një politike të qartë për arritjen e qasjeve parandaluese dhe kuruese që përmirësojnë shëndetin e studentit (pika 5.8; **Kapitulli I, Standardi III.8**).
- Mos ruajtjen e të dhënave statistikore për punësimin e të gjithë të diplomuarve (pika 5.9; **Kapitulli I, Standardi III.9**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti përditëson dhe zbaton sa më shpejt Statutin e tij duke përfshirë një deklaratë të qartë të misionit dhe synimeve (pika 1.1; **Kapitulli III, Standardi I.1**).
- Universiteti harton dhe zbaton sa më shpejt një strategji zhvillimi që përfshin misionin dhe qëllimin e tij, dhe përcakton synime të përshtatshme (pika 1.5; **Kapitulli III, Standardi I.5**).
- Universiteti sigurohet që Ministrisë t'i dorëzohet një raport vjetor brenda afateve të përshtatshme në përputhje me pritshmëritë ligjore dhe statutore (pika 1.6; **Kapitulli III, Standardi I.6**).
- Universiteti sigurohet që deri në vitin 2018 të ndërmerret në nivel qendror një studim tregu për të siguruar informacion për strategjinë e zhvillimit, misionin dhe qëllimin e saj (pika 1.8; **Kapitulli III, Standardi III.1**).
- Deri në vitin 2018, Universiteti duhet të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të dokumentuar ndaj vlerësimit periodik të performancës së stafit dhe aftësive të tyre (pika 2.4; **Kapitulli III, Standardi IV.3**).
- Universiteti duhet të shqyrtojë dhe rishikojë faqen e internetit deri në shtator të vitit 2018, për të ofruar një platformë të qëndrueshme, dy-gjuhëshe dhe në përputhje me qëllimin, që plotëson nevojat e të gjitha palëve të interesit (pika 2.7; **Kapitulli III, Standardi VII.1; Kapitulli III, Standardi VII.2**).
- Universiteti duhet të ndërmarrë hapa në afate të përshtatshme për të siguruar praninë e burimeve të mjaftueshme që mundësojnë mjedis dhe infrastrukturë të përshtatshme për performancën akademike dhe shkencore (pika 2.9; **Kapitulli III, Standardi IV.1**).
- Përpara fillimit të vitit të ardhshëm akademik, Universiteti duhet të shqyrtojë bazën e të dhënave të programeve të studimit dhe të sigurohet që ajo është e përditësuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore (pika 3.1; **Kapitulli I, Standardi I.1**).
- Universiteti duhet të hartojë dhe të zbatojë një qasje strategjike për rritjen e mobilitetit të studentëve (deri në gusht të vitit 2018) (pika 3.10; **Kapitulli I, Standardi I.10**).
- Universiteti duhet të sigurohet që të ketë një politikë dhe procedurë të qartë dhe të dokumentuar, që përcakton qasjen institucionale për vlerësimin (deri në gusht të vitit 2018) (pika 4.2; **Kapitulli I, Standardi II.2**).
- Universiteti harton dhe zbaton një politikë formale për plagjiaturën dhe shkeljet e tjera akademike (deri në gusht të vitit 2018) (pika 4.3; **Kapitulli I, Standardi II.2**).
- Universiteti duhet të qartësojë dhe të bëjë publike qasjen e tij për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit (deri në gusht të vitit 2018) (pika 4.4; **Kapitulli I, Standardi II.3**).
- Universiteti duhet të hartojë dhe zbatojë një strategji formale për kërkimin që orienton prioritetet kërkimore të institucionit (deri në gusht të vitit 2018) (pika 4.8; **Kapitulli I, Standardi I.4; Kapitulli I, Standardi I.5**).
- Universiteti duhet të ndërmarrë veprime sistematike për të përmirësuar ofrimin dhe aksesin në libra biblioteke dhe burime në internet (pika 5.5; **Kapitulli I, Standardi III.5**).
- Universiteti duhet të përcaktojë një politikë formale shëndeti me procedura për vlerësimin e efikasitetit të saj (deri në gusht të vitit 2018) (pika 5.8; **Kapitulli I, Standardi III.8**).
- Universiteti duhet të përcaktojë një strukturë dhe procedurat për mbledhjen dhe ruajtje e të dhënave lidhur me punësimin e të diplomuarve të vet (deri në gusht të vitit 2018) (pika 5.9; **Kapitulli I, Standardi III.9**).

Pohime mbi veprimet e ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se veprimet në vijim janë duke u ndërmarrë:

- Hapat e ndërmarrë nga Universiteti për të mbështetur punësimin përmes krijimit të Qendrave të Karrierës (pika 5.9; **Kapitulli I, Standardi III.9**).

Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimit dhe Menaxhimit të tij **janë përmbushur pjesërisht.**
- 2 Standardet për Burimeve **janë përmbushur kryesisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulës **janë përmbushur kryesisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënies, të Nxënit, Vlerësimit dhe Kërkimit **janë përmbushur pjesërisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre **janë përmbushur kryesisht.**

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin e Tiranës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Qeverisja e Universitetit dhe kuadrot e tij rregullatorë janë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar për institucionet e arsimit të lartë. [RVV fq. 5; M1] Universiteti përditëson dhe përmirëson rregulloret e tij sipas nevojës. [AE 3-5] Statuti i miratuar në vitin 2009 dhe in ndryshuar në vitin 2013, përcakton organizimin e brendshëm të Universitetit dhe strukturat drejtuese, si dhe përcakton përgjegjësitë individuale dhe formale të bordit. Megjithatë, Statuti nuk përmban një deklaratë të qartë të misionit dhe objektivave të Universitetit. [Statuti i shtypur datë 16 dhjetor 09; http://www.unitir.edu.al/images/STATUTI_UT_perditesuar_2016.pdf] Përpos kësaj, megjithëse Universiteti ka krijuar një grup pune për shqyrtimin e Statutit aktual dhe rregulloreve në kuadrin e përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë të vitit 2015, gjatë kohës së vizitës së vlerësimit nuk kishte një deklaratë të qartë të misionit dhe synimeve të Universitetit. [Dokumentet e RVV 1-64; AE 1-93] Grupi e konsideron mungesën e një deklarate të qartë të misionit dhe synimeve të Universitetit në Statutin e miratuar të vitit 2009, dhe vonesën e hartimit të një Statuti të përditësuar që merr në konsideratë ligjin për arsimin e lartë të vitit 2015, si një **dobësi**. Në këto rrethana, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të përditësojë dhe përmirësojë sa më shpejt Statutin dhe të përfshijë një deklaratë të qartë të misionit dhe synimeve të tij. [Kapitulli III, Standardi I.1]
- 1.2 Universiteti ka një strukturë drejtimi dhe organe vendim marrëse të përshtatshme që përmbushin pritshmëritë e Ministrisë. [RVV fq. 5-7; kopje e shtypur e Statutit datë 16 dhjetor 09] Stafi tha se mbledhjet e këtyre organeve lehtësojnë drejtimin institucional efikas. [M1, M 2, M 3] Megjithatë, faktet shtesë të siguruara nga Universiteti përpara vizitës përbëheshin vetëm nga procesverbalet e mbledhjeve, që nuk arrinin të vërtetonin në mënyrë efikase, frytshmërinë e drejtimit të tij organizativ. [AE 2, 8, 9-14]
- 1.3 Universiteti mbështet diskutimin dhe debatin konstruktiv në dhe mes organeve të tij vendim marrëse formale, që mbledhen rregullisht. [RVV fq. 8; M 1, M 2, M 3] Ndërkohë që stafi tha se informacioni në rendin e ditës mundësohet paraprakisht, Universiteti nuk ishte i aftë të siguronte prova me shkrim në mbështetje të kësaj pike. [Dokumentet RVV 1-64; AE 1-93] Anëtarët e Rektoratit dhe drejtuesit e lartë në shkollë fakulteti dhe departamenti janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të vendimeve. [RVV fq. 8; M 1, M 2, M 3; Dokumenti RVV 10]
- 1.4 Universiteti sigurohet që kufijtë e autonomisë së tij të respektohen dhe që ai ta ushtrojë autonominë e tij brenda kufijve të legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi. [RVV fq. 8&9; AE22-24; M1, M 2, M 3] Vetë qeverisja është e dukshme në njësitë akademike dhe administrative, gjatë veprimtarive të mësimdhënies dhe shkencore, dhe në lidhje me çështjet financiare dhe administrative. [AE 15 & 16; M1, M 2, M 3] Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve bëjnë mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm të veprimtarive të Universitetit. [M 2] Njësia është e bazuar kryesisht në fakultete, ndërsa njësia qendrore përpilon situatën e Universitetit bazuar në informacionin e raportuar nga fakultetet. Drejtoria ndërmerr mbikëqyrjen Universitare lidhur me çështje që lidhen me sigurimin e cilësisë. [AE 22-24; M 2] Anëtarësia e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet me Statut dhe përfshin një ekspert të jashtëm. [Kopja e Shtypur e Statutit datë 16 dhjetor 09 fq. 14] Megjithatë, Universiteti nuk ka përdorur konsulentë të jashtëm për të ndihmuar në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm të veprimtarive institucionale.
- 1.5 Universiteti deklaron se strategjia e tij e zhvillimit është e lidhur ngushtë me misionin

dhe synimet e tij, dhe diskutimet me stafin dhanë përshtypjen se e mbështesnin këtë pikëpamje. **[RVV fq. 9; M 1, M 2, M3]** Universiteti përfshiu në faktet fillestare bazë një përmbledhje të planit të tij strategjik që shtrihej në periudhën 2010-2012. Megjithatë, ky plan përmbledhës nuk përfshin misionin dhe qëllimin e Universitetit dhe nuk përcakton synime të përshtatshme për Universitetin. **[Dokumentet RVV 10, 11]** W Ndërkohë që Universiteti nuk ishte i aftë të mundësonte një strategji zhvillimi më të plotë dhe më të përditësuar, drejtuesit e lartë thanë se kjo strategji (dokumenti i vënë në dispozicion përmbante vetëm një listë të veprimtarive të propozuara), do të hartohej nga grupi i punës për Statutin dhe rregulloret në kohën e përshtatshme (shih pikën 1.1). **[M3]** Grupi e konsideroi mungesën e një strategjie zhvillimi aktuale, të përditësuar dhe të plotë si **dobësi [Kapitulli III, Standardi I.5]**. Në këto rrethana, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të hartojë dhe të zbatojë sa më shpejt një strategji zhvillimi, që përfshin misionin dhe qëllimet e tij dhe të përcaktojë synimet e përshtatshme **[Kapitulli III, Standardi I.5]**

- 1.6 Universiteti deklaroi në raportin e vetë vlerësimit se raporti vjetor për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (Ministria, MAS) dorëzohet përpara datës 20 dhjetor të çdo viti. **[RVV fq. 9]** Megjithatë, në dokumentacionin bazë të fakteve nuk ishte përfshirë një raport vjetor si shembull. **[Dokumentet RVV 1-64; AE 1-93]** Gjatë vizitës u theksua se në vitin 2016 nuk i ishte dorëzuar Ministrisë një raport vjetor, **[Takimime Koordinatorin Institucional]** dhe këtë grupi e konsideroi si **dobësi. [Kapitulli III, Standardi I.6]** Në këto rrethana, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të sigurohet që Ministrisë t'i dorëzohet një raport vjetor brenda afateve në përputhje me pritshmëritë ligjore dhe statutoare. **[Kapitulli III, Standardi I.6]**
- 1.7 Fakultetet dhe departamentet janë të organizuara në përputhje me kërkesat ligjore. Strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. Stafi akademik është i kualifikuar sipas kërkesave dhe ushtron autonomi dhe liri akademike gjatë mësimdhënies, punës kërkimore dhe veprimtarive të tjera akademike. Universiteti ka një faqe zyrtare interneti dhe ofron programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. **[RVV fq. 10-12; Informacion mbi IAL-të në faqen e APAAL; M1; M2, M3, M6, M7]**
- 1.8 Punësimi i të diplomuarve monitorohet nga Qendrat e Karrierës në secilin fakultet. **[RVV fq. 12 & 13; Ms 6 & 7]** Stafi akademik, punëdhënësit dhe rekrutuesit thanë se ka lidhje të forta midis organizatave vendore dhe rajonale dhe departamenteve dhe programeve. Kjo i mundëson fakulteteve, departamenteve dhe programeve të kenë informacionin e përshtatshëm për mundësitë zhvillimore ekonomike të rajonit. **[M 5, M 6]** Megjithatë, Universiteti nuk siguroi fakte të studimit të tregut në nivel institucional të ndërmarrë për të mbështetur misionin apo qëllimin e tij. **[1-64; AE 1-93]** Megjithëse stafi dha shembuj të studimit të tregut të ndërmarrë për të bazuar programet e zhvillimit, grupi e konsideron mungesën e studimit të tregut në nivel institucional për të bazuar misionin dhe qëllimin e Universitetit si **dobësi [Kapitulli III, Standardi III.1]**. Kështu, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të sigurojë ndërmarrjen, brenda vitit 2018, të një studimi tregu në nivel qendror për të dhënë informacion për strategjinë, misionin dhe qëllimin. **[Kapitulli III Standardi III.1]**
- 1.9 Universiteti ka një rrejt partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, që përfshijnë institucione të arsimit të lartë, organe publike dhe organizata biznesi. **[RVV fq. 13; AE 17-19]** Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë mbulon zhvillimin e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë, ndërsa departamentet sigurojnë mbarëvajtjen e bashkëpunimeve vendore dhe rajonale. **[M 3, M 5, M 6, M 7]** Po ashtu, bashkëpunimi me organizata të tjera për sigurimin e praktikave profesionale për studentët administrohen në nivel departamenti.
- 1.10 Universiteti ka hartuar dhe zbatuar politika për të mbështetur mobilitetin jashtë

vendit për stafin akademik dhe studentët. **[RVV fq. 13; FE19; FE5; FE20; FE8; AE75 – AE93; FE18; FE20-30; M 3, M 5, M 6, M 7]** Megjithatë, shfrytëzimi i ulët i mundësive të mobilitetit jashtë vendit për stafin dhe studentët, pranohet si një sfidë e vazhdueshme nga drejtuesit e lartë dhe shihet si një fushë që do të zhvillohet në të ardhmen. **[M 1, M 3]**

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e një deklaratë të qartë të misionit dhe synimeve të Universitetit në Statutin e miratuar në vitin 2009 dhe vonesën në hartimin e një Statuti të përditësuar që merr në konsideratë ligjin për arsimin e lartë të vitit 2015 (pika 1.1; **Kapitulli III, Standardi I.1**)
- mungesën e një strategjie zhvillimi aktuale, të përditësuar dhe të plotë (pika 1.5; **Kapitulli II, Standardi I.5**)
- Ministrisë nuk i është dorëzuar një raport vjetor për vitin 2016 (Pika 1.6; **Kapitulli III Standardi I.6**)
- mungesën e një studimi tregu në nivel institucion për të mbështetur misionin dhe qëllimin e Universitetit (pika 1.8; **Kapitulli III, Standardi III.1**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti të përditësojë dhe përmirësojë sa më shpejt Statutin dhe të përfshijë një deklaratë të qartë të misionit dhe synimeve të tij (pika 1.1; **Kapitulli III, Standardi I.1**)
- Universiteti të hartojë dhe të zbatojë sa më shpejt një strategji zhvillimi që përfshin misionin dhe qëllimet e tij dhe të përcaktojë objektivat e përshtatshme (pika 1.5; **Kapitulli III, Standardi I.5**)
- Universiteti të sigurohet që Ministrisë t'i dorëzohet një raport vjetor brenda afateve në përputhje me pritshmëritë ligjore dhe statutore (pika 1.6; **Kapitulli III, Standardi I.6**)
- Universiteti të sigurojë ndërmarrjen, brenda vitit 2018, të një studimi tregu në nivel qendror për të dhënë informacion për strategjinë, misionin dhe qëllimin (pika 1.8; **Kapitulli III, Standardi III.1**).

Pohim për veprimet e ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndërmarrjen e veprimeve.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur pjesërisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Universiteti ka një strukturë të qartë që përcakton përgjegjësitë për administrimin e burimeve për të përmbushur kërkesat e Standardeve Shtetërore të Cilësisë. [Statuti i UT; Rregulloret e UT; M 1, M 7; <http://www.unitir.edu.al/index.php/sq/rreth-nesh/organizimi/struktura-organizative>]. Punësimi i stafit të Universitetit rregullohet si nga statutet e jashtme ashtu edhe nga rregulloret e vetë Universitetit. [Statuti i UT; Rregulloret e UT] Universiteti mban regjistra të pozicioneve të punës me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. [2.2; 2.3; 2.4] Drejtoria e Burimeve Njerëzore shpall vendet e lira të punës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimeve Publike. Kriteret e punësimit i shpallen palëve të interesuara përmes faqes së internetit të Universitetit [2.1 Shpallje në faqen e Agjencisë së Prokurimeve Publike; www.app.gov.al; M 7; RVV fq. 15-16]. Procedura e punësimit për stafin administrativ është e njëjtë me atë për stafin akademik, dhe bazohet në Kodin e Punës [M7; Statuti i UoT; Rregulloret e UoT].

2.2 Synimi është të rekrutohet staf akademik i kualifikuar ndërkombëtar. [4.5; 4.6; M3; M6, RVV fq. 16-17]. Siç u theksua në pikën 1.10 stafi i fakulteteve mbështetet që të punojë me projekte me fonde të jashtme për të promovuar mobilitetin ndërkombëtar të stafit dhe studentëve përfshirë shkëmbimet, megjithëse shfrytëzimi i tyre është i ulët. [FE36; M3; M6]. Raporti i vetë vlerësimit shënon se akademikët e huaj janë pjesë e komisioneve për gradat profesor dhe personat të cilëve u jepet kjo gradë, pritet të kenë të paktën një vit përvojë në një universitet perëndimor. Megjithatë, grupit të vlerësimit nuk iu mundësuan fakte mbështetëse. [RVV fq.16-17; 4.1; M 8]

2.3 Universiteti deklaron se stafi jep kontribut për nisma ekonomike, shoqërore dhe mjedisore. Grupi RVV përfshin përfaqësues nga secili Fakultet. [M 2] Sipas politikës së Universitetit për integrimin, stafi akademik dhe ai mbështetës japin kontribut gjatë "ditëve të informacionit" ku studentët marrin informacion mbi studimet dhe angazhimet ekstra kurrikulare. [RVV fq. 19; 2.7; FE41; FE16]

2.4 Institucioni vë në dukje një sërë instrumentesh për vlerësimin periodik të performancës së stafit. Këto përfshijnë vlerësimin nga Rektorati dhe nga Dekanati, mbledhjet vjetore për të analizuar punën akademike dhe kërkimore dhe raportet vjetore për performancën akademike dhe kërkimore në shkallë departamenti. Çdo anëtar i stafit akademik plotëson një formular vetë vlerësimi për performancën e tyre të mësimdhënies dhe punës kërkimore, që dorëzohet në mbyllje të çdo viti akademik. Studentët plotësojnë vlerësime vjetore për zbatimin e programit dhe performancën e lektorëve. Praktika faktike ndryshon në varësi të fakultetit. [RVV fq. 16-17; M2, M3, M5, M6; 2.6; 17] Ndërkohë që grupit të vlerësimit iu mundësuan shembuj vlerësimi, përfshirë vlerësimin e lektorëve dhe të dhëna për rezultatet e punës kërkimore, ata nuk ishin të aftë të dallojnë një qasje gjithëpërfshirëse, të rregullt dhe të dokumentuar ndaj vlerësimit periodik të performancës dhe aftësive të stafit dhe e konsideroi këtë si një **dobësi**. [4.1; 4.3; 4.4; 2.6] Në këto rrethana, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që deri në vitin 2018 Universiteti të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse, të rregullt dhe të dokumentuar për vlerësimin periodik të performancës dhe aftësive të stafit. [Kapitulli III, Standardi IV.3]

2.5 Universiteti përpiqet të mëkojë një shpirt komuniteti dhe integrimi midis stafit dhe studentëve. [RVV fq. 17] Stafi dhe studentët konfirmuan pjesëmarrjen në veprimtari të përbashkëta, përfshirë pjesëmarrjen në panairë pune, veprimtari shoqërore dhe kampionate sportive. Ata gjithashtu deklaruan se kjo ndihmon me promovimin e integritit në komunitetin e Universitetit. [RVV fq. 17; 2.5; 2.7; M2, M4, M6]

2.6 Universiteti ka procedura transparente për administrimin e burimeve financiare. Administrimi financiar është në përputhje me kërkesat statutores, dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit i dërgohen raporte financiare çdo vit [RVV fq. 18-19; AE16-31; AE 27-28; 2; 5; M7]. Buxheti i delegohet çdo fakulteti në mbështetje të përmbushjes së prioritetëve kyçe.

[Statuti i UT; Rregulloret e UT; Mbledhjet 1, 2, 3, 6, 7] Kërkesat e departamenteve dhe fakulteteve shqyrtohen nga Senati dhe Bordi i Administrimit dhe më pas miratohen nga Rektorati. [Statuti i UT; Rregulloret e UT; M2, M7, M6, FE11; AE1; 7] Përgjegjësia përfundimtare për menaxhimin dhe administrimin e buxhetit është e Rektorit dhe Kancelarit, të mbështetur nga Drejtoria Ekonomike. [Statuti i UT; Rregulloret e UT; M 7, M 1]. Përfundimet e auditit financiar bëhen publike [Statuti i UT; Rregulloret e UT; RVV fq. 18-20; AE 27-31;

http://www.unitir.edu.al/images/Komunikimi/Programi_Vjetor_i_Auditimit_Viti_2015.pdf

2.7 Kuadri i menaxhimit të sistemeve të informacionit të Universitetit është i përcaktuar në rregulloren përkatëse. [AE36] Infrastruktura e menaxhimit të informacionit përfshin Sistemin e Menaxhimit të Studentëve, si dhe modulet e Burimeve Njerëzore dhe Pagave. Nuk ka një bazë të dhënash për regjistrimin e studentëve dhe rezultatet e vlerësimit. [RVV fq. 20; M6; M8; AE36] Të gjithë elementët funksionojnë në të gjitha fakultetet. Sistemi i studentëve u ofron studentëve programet e leksioneve, informacione për kursin, oraret e provimeve, dhe materialet e studimit. [Turi në kampus; M 4, M 8] Faqja e internetit e institucionit përfshin informacione standarde mbi veprimtaritë akademike, kulturore dhe shoqërore të institucionit. [RVV fq. 20; 2.7; Turi i kampusit; <http://www.unitir.edu.al/>] Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se ka një ndryshim të konsiderueshëm në përmbajtje dhe format midis fakulteteve të ndryshme. Disa prej tyre ofrojnë informacione dhe programe lëndësh gjithëpërfshirëse si dhe aspekte të përvojës studentore, ndërsa të tjera ofrojnë informacion të kufizuar. [p.sh., <http://www.feut.edu.al/>; <http://www.fhf.edu.al/>; <http://fdut.edu.al/>; <http://fshs-ut.edu.al/>] Për më tepër, faqja kryesore e internetit e Universitetit është kryesisht në gjuhën shqipe. Disa prej faqeve të saj janë të përkthyer në anglisht, ndërsa disa faqe të tjera janë 'akoma në zhvillim e sipër'. [<http://www.unitir.edu.al/>; <http://www.unitir.edu.al/index.php/sq/rreth-nesh/organizimi>; M7] Studentët në të tre ciklet e studimit vunë re ndryshimin midis fakulteteve dhe sugjeruan nevojën për një përmirësim të përgjithshëm. [M4a, M4b, M8] Grupi vuri re përmbajtjen, formatin dhe stilin, jo të rregullt të faqes së internetit, zhvillimin e papërshtatshëm të seksioneve kyçe dhe mbështetjen e saj në gjuhën shqipe dhe e konsideron këtë si **dobësi**. Në këto rrethana, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të shqyrtojë dhe përditësojë faqen e internetit deri në shtator të vitit 2018, duke siguruar një platformë të qëndrueshme, dy-gjuhëshe dhe të përshtatshme për qëllimin, që përmbush nevojat e të gjitha palëve të interesit. [Kapitulli III, Standardi VII.1; Kapitulli III, Standardi VII.2]

2.8 Universiteti ka një infrastrukturë administrative që mbështet stafin akademik dhe teknik dhe që ndihmon në ndërmarrjen efikase të veprimtarive të Universitetit. [RVV fq. 22; M2, M3, M4, M5, M6, M7; Turi i kampusit]

2.9 Universiteti ka në pronësinë e vet kampusin dhe ndërtesat që ndodhen në zona të ndryshme të qytetit të Tiranës. [RVV fq. 21,2.8; 2.10; Turi i kampusit] Përgjegjësitë për administrimin e burimeve dhe ambienteve janë të përcaktuara qartë në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit. Përgjegjësia për pronat e paluajtshme i takon Drejtorisë për Menaxhimin e Fondeve dhe Investimeve, që është pjesë e Rektoratit. [Statuti i UT; Rregulloret e UT; M1; M7; RVV fq. 21] Universiteti deklaroi se ka ambiente të përshtatshme për të përmbushur kërkesat statutores dhe ato të studimit dhe mësimdhënies. [RVV fq. 21-23; 2.9; 2.10] Megjithatë, u pranua gjithashtu se me rritjen e numrit të studentëve dhe me planet për një kampua qendror të cilat për momentin janë lënë pezull për arsye financiare, ka trysni të shtuar për sa i përket hapësirës. Financimi për të zgjidhur këtë situatë është kërkuar nga qeveria, por pa sukses. [RVV fq. 21-23; M1, M3, M7; Turi i kampusit] Universiteti ka trajtuar çështjen duke zgjidhur orarin e mësimdhënies, por studentët dhe stafi vazhdojnë të jenë të mendimit se hapësira dhe ambientet kanë nevojë të përmirësohen. Për më tepër, konteksti është i tillë që Universiteti nuk ka zhvilluar ambiente të tjera, përfshirë një bibliotekë qendrore dhe akses gjithëpërfshirës për studentët me aftësi

të kufizuara fizike. Gjithashtu, studentët vunë re se në shumë prej auditorëve nuk ka lidhje me internet Wi-Fi. **[M1, M3, M4, M7; Turi i kampusit; 2.8]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se trysnia e vazhdueshme mbi mjedisin dhe infrastrukturën për performancën akademik dhe shkencore është një **dobësi**. Në këto rrethana, **rekomandon** që Universiteti të marrë hapat e duhur në afatet e përshtatshme për të siguruar që ofrohen burime të mjaftueshme që i bëjnë mjedisin dhe infrastrukturën për arritjet akademike dhe shkencore të përshtatshme. **[Kapitulli III, Standardi V.1]**

2.10 Universiteti regjistron dhe ruan dokumentacionin zyrtar në përputhje me përcaktimet ligjore, përmes sistemit të integruar të menaxhimit të informacionit. **[RVV fq. 23-24; RVV 43; AE30-32]** Një sërë sektorësh, përfshirë atë të Protokollit dhe Arshivës, Teknologjisë së Informacionit dhe Burimeve Njerëzore janë përgjegjës për ruajtjen e dokumentacionit përkatës në mënyrë elektronike dhe shkresore. **[RVV 23-24; M2, M7]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e provave të një qasjeje gjithëpërfshirëse, të rregullt dhe të dokumentuar të vlerësimit periodik të performancës dhe aftësive të stafit (pika 2.4; **Kapitulli III, Standardi IV.3**)
- përmbajtjen, formatin dhe stilin jo të qëndrueshëm të faqes së internetit, zhvillimin e kufizuar të seksioneve kyçe dhe mbështetjen në gjuhën shqipe (pika 2.7; **Kapitulli III, Standardi VII.1; Kapitulli III, Standardi VII.2**)
- trysninë e vazhdueshme ndaj mjedisit dhe infrastrukturës për performancën akademike dhe shkencore (pika 2.9; **Kapitulli III, Standardi V.1**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- deri në vitin 2018 Universiteti duhet të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse, të rregullt dhe të dokumentuar për vlerësimin periodik të performancës dhe aftësive të stafit (pika 2.4; **Kapitulli III, Standardi IV.3**)
- Universiteti duhet të shqyrtojë dhe përditësojë faqen e internetit deri në shtator të vitit 2018, duke siguruar një platformë të qëndrueshme, dy-gjuhëshe dhe të përshtatshme për qëllimin, që përmbush nevojat e të gjitha palëve të interesit. (pika 2.7; **Kapitulli III, Standardi VII.1; Kapitulli III, Standardi VII.2**)
- Universiteti duhet të marrë hapat e duhur në afatet e përshtatshme për të siguruar që ofrohen burime të mjaftueshme që i bëjnë mjedisin dhe infrastrukturën për arritjet akademike dhe shkencore të përshtatshme (pika 2.9; **Kapitulli III, Standardi V.1**).

Pohime për veprime që po ndërmerren

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndërmarrje e veprimeve.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Universiteti ofron një gamë të gjerë programesh studimi dhe karakterizohet nga llojshmëria e fakulteteve, degëve, drejtimeve, profileve të studimit, specializimeve dhe kualifikimeve të tij [RVV fq. 25; AE16]. Ofrohen programe studimi në të tre ciklet e studimit: bachelor (36 programe studimi), master (100 programe studimi) dhe doktoraturë (28 programe studimi). [AE 8] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se baza e të dhënave të programeve të studimit të Universitetit në faqen e internetit të APAAL-së nuk është e përditësuar, përmban dyzime dhe nuk ka referenca të dokumentacionit ligjor, dhe e konsideroi këtë si **dobësi** [Profili i institucionit - UT; http://www.aaal.edu.al/index.php?option=com_content&view=article&id=690&Itemid=306&lang=en]. Në këto rrethana, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që deri në fillim të vitit të ardhshëm akademik, Universiteti të shqyrtojë bazën e të dhënave të programeve të studimit për t'u siguruar që ajo është e përditësuar, e saktë dhe në përputhje me kërkesat ligjore. Programet e studimit në të tre ciklet e studimit janë në përputhje me vizionin strategjik të Universitetit. Ato kanë si qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë për t'i shërbyer lirisë dhe dinjitetit, llojshmërisë së ideve, krijimit dhe konsolidimit të një shoqërie demokratike, sundimit të ligjit dhe përmirësimit të mirëqenies dhe dinjiteti njerëzor, të arritura përmes veprimtarive transparente dhe të ligjshme. [RVV fq. 25; FE16][Kapitulli I, Standardi I.1]
- 3.2 Përveç studimeve me kohë të plotë në të tre ciklet e studimit, Universiteti ofron kurse të hapura dhe afat-shkurtra dhe shkolla verore të orientuara të ofrojnë aftësi dhe formim të specializuar. [RVV fq. 26; M4; Statuti i UT; Rregulloret e UT]. Në përputhje me Ligjin e ri për Arsimin e Lartë, ofrimi i programeve me kohë të pjesshme po mbyllet [FE27; M7].
- 3.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit nuk është përditësuar që prej vitit 2012, megjithëse Universiteti po punon aktualisht për një strategji dhe plan të ri veprimi, që do të pasqyrojnë ndryshimet e Ligjit të ri (shih Seksionin 1.5). [FE3; M3]. Udhëzimet për programet e studimit përfshijnë informacion mbi diplomën e lëshuar pas përfundimit të studimeve, që shoqërohet nga Suplementi i Diplomës në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane [Udhëzuesi i Studentit (në Shqip): <http://www.feut.edu.al/FEUT-%20Guida%20e%20studentit%202016.pdf>; FE14]
- 3.4 Universiteti ka dy filiale në Sarandë dhe në Kukës, të hapura për t'iu përgjigjur kërkesave të bashkive për të hapur kampuse më afër vendbanimeve të studentëve. Prurjet në këto filiale kanë qenë më të ulëta se pritshmëritë dhe po merret në konsideratë mbyllja e tyre. [RVV fq. 13, 40; M3]. Fakultetet ofrojnë një sërë programesh ndërdisiplinore të hartuara për të pasqyruar zhvillimet në shoqërinë shqiptare dhe nevojat e tregut të punës. [RVV fq. 27] Ofrohen edhe Programe Masteri të Përbashkëta me universitete të huaja partnere. [FE29] Në Universitet ftohen staf akademik nga jashtë për të dhënë mësim në kurse të ndryshme, kryesisht në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. [FE24]
- 3.5 Ngarkesa mësimore e lektorëve caktohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në bazën nënligjore përkatëse. [AE54; FE6; RVV fq. 27] Mësimdhënia shtesë mbi normën normale financohet nga burimet e Universitetit. Stafi akademik ka marrëveshje individuale vjetore që përcaktojnë detajet e ngarkesës mësimore, detyrat administrative, punën kërkimore dhe veprimtaritë e tjera. [AE39; M5]
- 3.6 Programet e studimit janë të publikuara në faqet zyrtare të fakulteteve. [<http://www.feut.edu.al/mba.html>, <http://www.feut.edu.al/master.html> , <http://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2014/11/MASTER-I-SHKENCAVE-N%C3%8B-E->

[DREJT%C3%8B-PENALE-2016-2017.pdf etj](#)] Ato gjithashtu u mundësohen të diplomuarve të shkollave të mesme dhe studentëve të tjerë të interesuar përmes prezantimeve dhe broshurave informuese gjatë javës së parë të programit të studimit. **[FE16; FE41; M4a; M4b; M6]** Kriteret e pranimit përcaktohen nga departamentet, miratohen nga Senati Akademik dhe më pas bëhen publike në faqen e internetit. **[M3; FE25; <http://www.unitir.edu.al/>]** Në mënyrë të ngjashme kuotat e pranimit të studentëve propozohen nga departamentet dhe fakultetet bazuar në kapacitete dhe miratohen nga Senati, përpara se të marrin miratimin përfundimtar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[FE25; FE21]**

- 3.7 Informacioni thelbësor për programet, përfshirë synimet, modulet me kredite, dhe oraret janë të dhëna në faqen e internetit. **[<http://www.feut.edu.al/mba.html> , <http://www.feut.edu.al/master.html>]** Grupit iu tha se departamentet dhe qendrat e karrierës i informojnë sistematikisht studentët e ciklit të parë mbi mundësitë e punësimit, por shumica e studentëve faktikisht vijojnë në ciklin e dytë të studimeve, kryesisht në programe studimi të masterave profesionale të ofruar nga Universiteti. **[RVV fq. 28; M4; M6]** Vëmendja më e kufizuar ndaj aftësisë për t'u punësuar gjatë programeve të ciklit të parë i ka shtyrë disa departamente të hartojnë programe studimi të integruara, që theksojnë njohuritë bazë dhe metodat e përgjithshme shkencore, ndërkohë që ofrojnë mundësi më të qarta transferimi në programet e studimit të ciklit të dytë. **[M3, Shembull i Fakultetit të Drejtësisë]**
- 3.8 Stafi akademik përfshihet në punë kërkimore në mënyrë rutinë, që jep kontribut për cilësinë e mësimdhënies, veçanërisht për ciklin e dytë dhe të tretë të studimit. Më shumë se 75 për qind e stafit akademik kanë gradën doktor dhe 41 për qind kanë titullin e Profesorit të Asociuar ose Profesorit. **[FE6; M4; M8]** Metodot e mësimdhënies ndryshojnë në varësi të programeve të ndryshme, por ato janë përforcuar nga kualifikimet e përmirësuara të stafit akademik dhe mundësitë e shkëmbimit me kolegët evropianë në Universitet dhe jashtë vendit. **[M6]** Departamentet caktojnë koordinatoret e programeve të studimit, që janë përgjegjës për përmbajtjen dhe performancën e kurseve të veçanta, si dhe për të mbështetur studentët. Ata mbështeten nga stafi administrativ, i teknologjisë së informacionit dhe stafi tjetër akademik për ndihmesën që i jepet studentëve. **[M6; Turi i kampusit; M7; FE28]** Studentët janë të mendimit se komunikimi i stafit administrativ duhet të përmirësohet përmes përdorimit të sistemeve të informacionit elektronik. **[Anketimi i Studentëve]**
- 3.9 Universiteti ofron 100 programe studimi të ciklit të dytë të ndarë në 65 programe masteri shkencor dhe 35 programe masteri profesional. **[FE8]** Është e detyrueshme një temë që mbart mes 25 dhe 30 për qind të kreditove, ku studentët priten të kryejnë një projekt kërkimor. **[AE25; RVV, fq. 29; M4]**. Studentët kanë gjithashtu detyrimin të kryejnë një praktikë profesionale të organizuar në bashkëpunim me institucionet shtetërore, shoqëritë publike apo korporatat private. **[AE41-AE44; FE12; M5]** Gjatë vitit akademik 2015-16, stafi akademik me kohë të plotë kreu 77 për qind të mësimdhënies, ndërsa stafi me kohë të pjeshme kreu pjesën e mbetur. **[FE6]** Përfaqësues nga bizneset mund të përfshihen në mësimdhënie, përfshirë edhe si drejtues të temave të diplomës. **[M5]**
- 3.10 Programet e studimit janë të organizuara në tre cikle të njëpasnjëshme në përputhje me Sistemin e Bolonjës. Ato kanë module që janë të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Kreditet e fituara në institucionet vendase dhe të huaja njihen nga rregulloret e Universitetit. **[FE19; FE5; FE20; FE8; AE75-AE93; FE18]** Studentët e ciklit të dytë dhe të tretë priten të jenë të aftë të komunikojnë në një gjuhë të huaj në një nivel të njohur ndërkombëtarisht. **[RVV fq. 27]** Kjo qasje e përgjithshme është ideuar për të promovuar mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë. Megjithatë, mobiliteti i

studentëve të Universitetit në Evropë është krahasimisht i ulët dhe arrin vetëm në pak më shumë se 5 për qind. **[Anketimi i Studentëve; M4]** Është e qartë që pengesat financiare kufizojnë mobilitetin e studentëve. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se përveç ofrimi të gjuhës angleze, programet e studimit jepen në gjuhën shqipe. Për më tepër, niveli i njohurive të anglishtes për një pjesë të stafit akademik nuk është i lartë. **[M1, M2, M3, M6, M7]** Grupi dëgjoi se Universiteti është përpjekur të trajtojë këtë çështje të mobilitetit duke hyrë në një sërë marrëveshesh me universitete në vende të tjera evropiane. Gjithashtu njihet nevoja për të hapur programe që jepen në gjuhën angleze. **[M1; FE30-40]** Megjithatë, grupi arriti në përfundimin se mobiliteti i ulët i studentëve në programet evropiane është një **dobësi**. Në këto rrethana, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të hartojë dhe zbatojë një qasje strategjike për rritjen e mobilitetit të studentëve (deri në gusht të vitit 2018). **[Kapitulli I, Standardi I.10]**

- 3.11 Integrimi i zbatimit praktik dhe njohurive teorike në programet e studimit arrihet përmes mënyrave të ndryshme, përfshirë ushtrimet, punën laboratorike, detyrat praktike dhe projektet, praktikën profesionale dhe temën përfundimtare. **[AE25; M4; RVV fq. 31]**. Siç është theksuar, studentët e ciklit të dytë duhet të kryejnë një praktikë të detyrueshme profesionale që vlen nga 6 deri në 10 kredite dhe të shkruajnë një temë diplome. **[AE25; <http://www.feut.edu.al:3000/msc/finance-investment.html> etj; M4; <http://www.feut.edu.al:3000/prof-administrim-biznes.html> etj; RVV fq. 31]** Disa programe studimi bachelor kërkojnë gjithashtu një temë diplome, por kjo ndryshon në varësi të fakulteteve. **[M4; RVV fq 31]** Rregulloret, kriteret dhe standardet për tezën janë të përcaktuara qartë. **[AE25]**
- 3.12 Universiteti deklaron se programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë janë hartuar duke përfshirë aftësi të punësueshmërisë. **[RVV fq. 31; M5]** Ndërkohë që faqet e internetit të fakulteteve të ndryshme nuk tregojnë qartësisht nëse programet e bachelorit janë të orientuara drejt punësueshmërisë, programet e ciklit të dytë duket të përfshijnë module që janë drejtpërsëdrejti të lidhura me fusha të specializimit profesional. **[RVV fq. 31; p.sh, <http://www.feut.edu.al/mprof.html>]** Universiteti ka për qëllim të hapë programe studimi të mëtejshme të ciklit të dytë që janë ndërdisiplinore dhe ndërkombëtare për të ndihmuar të diplomuarit të plotësojnë nevojat e tregut shqiptar të punës. **[RVV fq. 31; M4; <http://euro-ps.org/>]** Çdo fakultet ka krijuar një Qendër Karriere, me synim t'i ofrojë studentëve informacion dhe mbështetje për praktikën dhe punësimin. **[RVV faqe 31; M4]**. Megjithatë, nuk ishte e qartë nëse synimet e të gjitha programeve janë të orientuara drejt përgatitjes së studentëve për punësim, studentët që u takuan me grupin e vlerësimit ishin të mendimit se programet e tyre ofrojnë mundësi punësimi. **[M4a; M4b]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi vlerësimit identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- baza e të dhënave e programeve të studimit nuk është e përditësuar, ka dyzime dhe ka mungesë referencash të dokumentacionit ligjor (pika 3.1; **Kapitulli I, Standardi I.1**)
- mobilitetin e ulët të studentëve në programe evropiane (pika 3.10; **Kapitulli I, Standardi I.10**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- deri në fillim të vitit të ardhshëm akademik, Universiteti të shqyrtojë bazën e të dhënave të programeve të studimit për t'u siguruar që ajo është e përditësuar, e saktë dhe në përputhje me kërkesat ligjore (pika 3.1; **Kapitulli I, Standardi I.1**)
- Universiteti të hartojë dhe zbatojë një qasje strategjike për rritjen e mobilitetit të studentëve (deri në gusht të vitit 2018) (pika 3.10; **Kapitulli I, Standardi I.10**).

Pohime mbi veprimet e ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndërmarrjen e veprimeve.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mesimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Përshkrimet e programeve të studimit, të cilët janë në gjuhën shqipe dhe me shumëllojshmëri formatesh, janë të bëra publike në faqet e internetit të fakulteteve. [p.sh., <http://fshs-ut.edu.al/programet-ba-3/>; <http://www.fhf.edu.al/msh-ne-arkeologji/>] Universiteti i siguroi grupit përshkrime të programeve nga Fakulteti i Ekonomisë dhe këto përfshijnë një panoramë të kursit, rezultatet e të nxënësve, metodat e mësimdhënies, përmbajtjen e kursit, vlerësimin dhe përmbajtjen e modulit. [AE75-93; 7; 18; M2; 25] Nuk ishte e qartë nëse fakultete të tjera zbatojnë të njëjtën praktikë, megjithëse studentët deklarojnë se oraret e mësimdhënies janë të përshtatshme dhe se stafi akademik ofron mbështetje për studentët. [M4, M8] Fakultetet janë përgjegjëse për planifikimin e orëve të mësimin dhe planin e saktë të punës për vitin. [039] Vlerësimi bazohet kryesisht 50 për qind në provimin përfundimtar dhe 50 për qind në pjesën praktike dhe punën gjatë kursit. [M2; M4a; M4b] Stafi pranoi kritikën e studentëve për mungesën e aksesit në internet përmes Wi-Fi dhe në bibliotekë, sipas diskutimit të bërë në seksionet 2.6, 2.7 dhe 5.5. [M4, M6, M8, Anketimi me Studentët]
- 4.2 Në fillim të çdo viti akademik, pas regjistrimit të studentëve, kodet dhe fjalëkalimet e studentëve gjenerohen nga një Administrator i Sistemit të Informacionit, një pozicion në Rektorat, dhe këto kredenciale përdoren për të hyrë në portal dhe për të pasur akses në informacionin individual të studentit. [[RVV fq. 33; Turi i Kampusit] Çdo fakultet ka rregullat e veta, të miratuara nga Këshillat e Fakulteteve, për proceset e vlerësimit. Studentët mund të këshillohen me faqet e internetit të fakulteteve për kalendarin e provimeve, kriteret e diplomimit, udhëzime mbi procedurën e vlerësimit dhe informacione të tjera të lidhura me vlerësimin. [RVV fq. 34; 14; 16; <http://www.unitir.edu.al/>] Sistemi i regjistrave të studentëve i mundëson stafit akademik të hedhin notat e studentëve, që sipas vetë vlerësimit, duhet të firmoset nga të paktën dy pedagogë të caktuar nga Shefi i Departamentit. [RVV, fq. 35] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se procedurat e vlerësimit ndryshojnë në varësi të fakultetit. [M2; M3, M6, 14; 16] Në këtë kontekst, grupit nuk iu siguruan prova të qarta dhe të dokumentuara të një sistemi moderimi që do t'i siguronte palët e interesit se proceset e vlerësimit janë të vlefshme, të sakta dhe të drejta. Grupi gjykon se kjo është një **dobësi**. Në këto rrethana, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të sigurohet që të ketë një politikë dhe procedurë të qarta dhe të dokumentuar që përcakton qasjen institucionale për vlerësimin (deri në gusht të vitit 2018). [Kapitulli I, Standardi II.2]
- 4.3 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re shqetësimet e shprehura në Anketimin me Studentët në lidhje me shkeljet akademike dhe veçanërisht me fenomenin e kopjimit gjatë provimeve. Megjithëse atyre iu mundësuan prova në lidhje me një vendim të Këshillit të Etikës për plagjiaturën [014; 16; 4], atyre nuk iu siguroi një politikë formale për plagjiaturën dhe shkelje të tjera akademike, dhe si rrjedhojë e gjykuan këtë pikë si **dobësi**. Në këto rrethana, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të hartojë dhe të zbatojë një politikë formale për plagjiaturën dhe shkeljet e tjera akademike (deri në gusht të vitit 2018). Studentëve iu jepet një Diplomë dhe një Supplement Diplome pas përfundimit me sukses të programit të tyre të studimit. [FE14] Studentët që u takuan me grupin e vlerësimit nuk ishin në dijeni të procedurave të ankesave nga studentët dhe apelimeve akademike, megjithëse Rregulloret e Universitetit kane pjesë për apelimet dhe ankesat. [M4; Anketimi me Studentët; Rregulloret e UT, Neni 51, RVV fq. 47; AE37][Kapitulli I, Standardi II.2]
- 4.4 Raporti i vlerësimit të brendshëmdeklaroi se në nivel departament, stafi akademik

shqyrton dhe përditëson kurrikulën për çdo program studimi dhe se ndryshimet miratohen nga departamenti dhe fakulteti. Pikëpamjet e studentëve përtohen nga anketimet me studentët dhe pyetësorët e vlerësimit. Stafi i tha grupit të vlerësimit se Komisionet e Programeve mbledhen dy herë në vit dhe japin kontribut për këto shqyrtime. Të gjitha përmirësimet bëhen nga Senati Akademik, i cili nëse ka ndryshime në masë më të madhe se 20 përqind në programin e studimit, duhet të miratojë ndryshimet. [RVV fq. 26, 35-36; FE10; FE9; M2; M3; M4; M5; M6; M7; 17; AE38] Ndërkohë që stafi dhe studentët janë në dijeni, dhe është e qartë se përfshihen në proceset e shqyrtimit, nuk ishte e qartë nëse kishte ndryshime thelbësore midis fakulteteve. [M2; M3; M6] Grupit nuk iu mundësuan rolet përkatëse të Njesisë së Brendshme të Kontrollit të Cilësisë, që punon me fakultetet, dhe të Drejtorisë qendrore të Kurrikulës dhe Standardeve. [M2; M3; M4; M5; M6; M7] Përgjithësisht nuk ishte e dukshme se kishte një politikë të qartë dhe të dokumentuar të Universitetit për sigurimin e cilësisë të programeve të studimit dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e gjykon këtë si **dobësi**. Në këto rrethana, **rekomandohet** që Universiteti të qartësojë dhe të bëjë publike qasjen e tij për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit (deri në gusht të vitit 2018). **Kapitulli I, Standardi II.3]**

- 4.5 Universiteti deklaroi se përdor mënyra të ndryshme për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Drejtuesit e lartë shpjeguan se për stafin akademik është detyrim ligjor të përditësojnë dhe zhvillojnë më tej aftësitë e tyre profesionale. Grupit të vlerësimit iu tha se angazhimi në programe trajnimi në Universitet dhe jashtë vendit ndihmon në përmirësimin e mësimdhënies, megjithëse u tha edhe se financimi për mobilitet në Evropë është i kufizuar. [M3; RVV fq. 37; M6] Ndërmerret edhe vëzhgim i mësimdhënies nga kolegët, por kjo duket se varet nga angazhimi individual dhe nga praktikat e ndryshme në fakultete. Nuk ka një politikë të Universitetit për vëzhgimin nga kolegët. [M2; M3; M6] Raporti i vlerësimit të brendshëm deklaroi se stafi akademik i nënshtrohet vlerësimeve periodike përmes mënyrave të ndryshme. Megjithatë, siç edhe u theksua në pjesën e dobësive dhe rekomandimeve të seksioneve 2.4 dhe 4.4, nuk është e qartë që Universiteti ka një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. [RVV fq. 16-17; M2; M3; M5; M6; 2.6; 17] Me gjithë këtë, studentët ishin përgjithësisht pozitiv në lidhje me organizimin e studimeve të tyre, metodologjinë e përdorur nga pedagogët dhe këshillat dhe mbështetjen e dhënë nga stafi akademik. [M4; M8; Anketimi me Studentët]
- 4.6 Departamentet shihen si njësit bazë të kërkimit, ku secili prej tyre harton një strategji të punës kërkimore. Fakultetet i propozojnë Rektoratit për miratim një buxhet vjetor për kërkimin, që më pas i shpërndahet departamenteve. Departamentet dhe fakultetet hartojnë më pas raporte vjetore për performancën dhe rezultatet e kërkimit. [RVV fq. 37-38; M2; M3; M6; M7; AE33] Sasia e punës kërkimore e botuar nga stafi akademik i të gjitha departamenteve ka një prirje në rritje, por është akoma e ulët në disa fakultete. [AE49]
- 4.7 Mobiliteti i stafit në Evropë për kërkimin dhe veprimtari të tjera akademike, përfshirë mësimdhënien mbështetet nga Universiteti. Ai organizon dhe merr pjesë gjithashtu në konferenca shkencore në Shqipëri dhe në vende të tjera. [AE49] Ka një program që i mundëson stafit akademik nga institucione në vende të tjera të kenë pozicione të përkohshme kërkimore dhe mësimdhënieje në Universitet dhe për të bashkëpunuar në projekte kërkimore. Universiteti ka nënshkruar edhe një sërë marrëveshjesh shkëmbimi me universitete në të gjithë Evropën. [AE50; AE66; FE30-40] Megjithatë, përgjithësisht mobiliteti është i kufizuar për shkak të pengesave financiare dhe shfrytëzimi i mundësive është më i ulët nga sa dëshirojnë Universiteti dhe stafi. [M3; M6; Anketimi i Pedagogëve] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se mbizotërimi i gjuhës shqipe në faqen e internetit dhe aftësitë e

kufizuara në gjuhë të huaja mund të shkaktojnë nivelet e ulëta të mobilitetit të stafit. [<http://www.unitir.edu.al/>; M1; M2; M3; M6; M7]

- 4.8 Siç u përmend, departamentet drejtojnë prioritetet e kërkimi, Universiteti deklaron se synimet e departamenteve për punën kërkimore marrin në konsideratë strategjinë e vet të zhvillimit dhe synimet strategjike. [RVV fq. 39] Megjithatë, nuk ishte e qartë se si arrihet ky harmonizim dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se mungesa e një strategjie formale për kërkimin, që drejton prioritetet e kësaj pune është një **dobësi**. Në këto rrethana, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universitetit të hartojë dhe të zbatojë një strategji formale për të drejtuar prioritetet institucionale për kërkimin (deri në gushtë të vitit 2018). [Kapitulli I, Standardi I.4; Kapitulli I, Standardi I.5]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e provave të qartë dhe të dokumentuara të një sistemi moderimi që do t'i siguronte palët e interesit se proceset e vlerësimit janë të vlefshme, të sakta dhe të drejta (pika 4.2; **Kapitulli I, Standardi II.2**)
- mungesën e një politike formale për plagjiaturën dhe shkeljet e tjera akademike (pika 4.3; **Kapitulli I, Standardi II.2**)
- mungesën e një politike të qartë dhe të dokumentuar të Universiteti për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit (pika 4.4; **Kapitulli I, Standardi II.3**)
- mungesën e një strategjie formale të kërkimit që drejton prioritetet (pika 4.8; **Kapitulli I, Standardi I.4; Kapitulli I, Standardi I.5**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti të sigurohet që të ketë një politikë dhe procedurë të qartë dhe të dokumentuar që përcakton qasjen institucionale për vlerësimin (deri në gusht të vitit 2018) (pika 4.2; **Kapitulli I, Standardi II.2**)
- Universiteti të hartojë dhe të zbatojë një politikë formale për plagjiaturën dhe shkeljet e tjera akademike (deri në gusht të vitit 2018) (pika 4.3; **Kapitulli I, Standardi II.2**)
- Universiteti të qartësojë dhe të bëjë publike qasjen e tij për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit (deri në gusht të vitit 2018) (pika 4.4; **Kapitulli I, Standardi II.3**)
- Universitetit të hartojë dhe të zbatojë një strategji formale për të drejtuar prioritetet institucionale për kërkimin (deri në gusht të vitit 2018) (pika 4.8; **Kapitulli I, Standardi I.4; Kapitulli I, Standardi I.5**).

Pohime mbi veprimet e ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndërmarrjen e veprimeve.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur pjesërisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Statutet e Universitetit përcaktojnë rolin e Senatit për t'i propozuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës kriteret dhe kuotat për pranim, dhe përcaktojnë kriteret specifike për përzgjedhjen e studentëve të ciklit të parë. [FE2] Rregulloret specifikojnë se Universiteti duhet të shpallë programet e studimit të akredituara që ofron përpara fillimit të procedurave të pranimit. [AE37] Kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit për programet e ciklit të dytë përcaktohen nga Këshilli i Ministrave [AE37]. Universiteti është aktiv në promovimin e programeve të tij përmes ditëve të hapura të organizuara nga Qendrat e Karrierës dhe përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve informuese. [RVV fq. 42-43; GID; M1] Studentët të cilët u takuan me grupin e vlerësimit thanë se ishin përgjithësisht të kënaqur me informacionin e marrë për programet e tyre të studimit kur ata aplikuan për herë të parë për to dhe konfirmuan se programet përmbushnin pritshmëritë e tyre. [M4] Megjithatë, sipas Anketimit të Studentëve, vetëm 44 për qind e studentëve kanë marrë informacion rreth Universitetit dhe për pak se 2 për qind kanë marrë informacion mbi politikat e rimbursimit përpara fillimit të shkollimit. [Anketimi i Studentëve] Studentët identifikuan gjithashtu shqetësime lidhur me cilësinë dhe aksesin në informacione mbi programin në faqen e Universitetit. [<http://www.unitir.edu.al/>; M4] Kjo kontribuon në dobësinë dhe rekomandimin e identifikuar në seksionin 2.6. Universiteti mirëpret studentë huaj, por përveç studentëve që kryejnë shkëmbime, numri i të huajve që studiojnë në Universitete është shumë i ulët. [GID; M6] Raporti midis stafi akademik me kohë të plotë dhe studentëve në Universitet është 1 me 23. [SED fq. 43; GID] Raporti midis stafit dhe studentëve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja për veprimtari praktike është 1 me 11. [FE12]
- 5.2 Çdo fakultet ruan në zyrat e sekretarisë dosjet personale të studentëve që përmbajnë informacionet e kontaktit dhe dëftesat e shkollës së mesme. [RVV fq. 44; AE 56; FE 19; M6] Zyra e Informacionit ofron udhëzime mbi orientimin e studentëve. Sekretaria Mësimore ofron informacione mbi programet e studimit, dhe Zyra e Shërbimeve dhe Teknologjisë së Informacionit e Qendrat e Karrierës ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për studentin. [RVV fq. 44; AE54; Turi i kampusit] Programi kompjuterik i menaxhimit të studimit mbështet komunikimin e stafit dhe studentit. [RVV fq. 44; 014]
- 5.3 Kur nisin programin e tyre të studimit, studentëve u bëhet një orientim. [M4; M6] Bibliotekat e fakulteteve mbështesin orientimin e studentëve përmes zhvillimit të aftësive të menaxhimit të informacionit. [RVV fq. 43; AE63] Në Anketimin e Studentëve, më shumë se 90 për qind e studentëve u përgjigjën se marrëdhëniet midis stafit dhe studentëve janë të mira, duke theksuar nivele të larta të angazhimit të stafit. Studentët folën me pozitivitet për mbështetjen që marrin dhe doktorantët folën për marrëdhënie të ngushta midis tyre dhe udhëheqësve. Më shumë se 80 për qind e studentëve u përgjigjën se këshillat e stafit në rastin më të keq janë të mjaftueshme. [Anketimi me Studentët; M4; M6; M7] Universiteti i ofron studentëve mundësinë të transferojnë studimet e tyre në programe studimi të të njëjtit cikël gjatë viteve të ndërmjetme brenda Universitetit ose në institucione të tjera të arsimit të lartë. [AE58; AE59] Vendimet e pranimit për transferimet e propozuara merren nga Rektori, duke marrë në konsideratë mendimin e dekanit pritës dhe kapacitetin e programit, si dhe rezultatin e njohjes së programit. [RVV fq. 45; AE37] Pas përfundimit të programit të studimit të ciklit të parë, shumë studentë aplikojnë për një program studimi në ciklin e dytë. [RVV fq. 45; M4; M8]
- 5.4 Sipas Rregulloreve të nxjerra nga MAS, Universiteti i kushton vëmendje të veçantë studentëve të ardhshëm nga territoret shqipfolëse, si nga Republika e Kosovës dhe studentëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvedeva dhe Bujanovaci, si dhe atyre me nevoja të veçanta. Universiteti ka mbështetur një

sërë studentësh të tillë duke u ofruar përjashtim të plotë ose gjysmë përjashtim nga tarifa e shkollimit.[RVVfq. 45;GID;AE59; M1; M3; M6; M7]Gjatë tre viteve të fundit, rreth 285 studentë nga këto grupe janë pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Studentët e ciklit të parë përfitojnë përjashtim të plotë nga tarifa e shkollimit, ndërsa studentët e ciklit të dytë paguajnë vetëm gjysmën e tarifës së shkollimit.[AE1] Sipas rregulloreve të MAS, ofrohet edhe një skemë bursash. [RVV fq. 45; AE20; AE21; AE60; AE61] Kuotat e pranimit dhe tarifat e veçanta të shkollimit për programet me kohë të pjeshme përcaktohen nga aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave dhe MAS, por siç edhe u theksua, ndryshimet në ligj aktualisht po shkaktojnë ndërprerjen e programeve me kohë të pjeshme. [RVV fq. 45 AE37; M7]

- 5.5 Universiteti ka gjashtë biblioteka në fakultete me libra në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera. [RVV fq. 46; GID; M3; Turi i kampusit] Orari i punës i bibliotekave është i shpallur dhe 90 përqind e studentëve janë të kënaqur me mbështetjen e ofruar nga biblioteka.[AE54; Anketimi me Studentët] Po vijon puna për digjitalizimin e bibliotekës së Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë.[Turi i Kampusit] Literatura shtesë ofrohet përmes bibliotekave në internet me të cilat Universiteti ka marrëveshje. [RVV fq. 34; Turi i kampusit; M7] Grupit të vlerësimit iu tha se të gjitha kërkesat për fonde bibliotekë janë përmbushur plotësisht, megjithëse në Anketimin e Studentëve, rreth 30 përqind e tyre u përgjigjën se nuk janë të kënaqur me aksesin në tekste shkollore dhe 40 përqind u përgjigjën se nuk janë të kënaqur me aksesin në burime elektronike. Studentët dhe stafi me të cilët grupi u takua gjatë vizitës shprehën pakënaqësinë e tyre me ofrimin dhe aksesin si në tekste shkollore, ashtu edhe materiale në internet, dhe megjithëse është pranuar se ka plane në hapat e para për zhvillimin e bibliotekës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi këtë si **dobësi**. [M3; M4; M7] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të ndërmarrë që qasje sistematike për përmirësimin e aksesin në libra bibliotekë dhe burime në internet. [Kapitulli I, Standardi III.5]
- 5.6 Fakultetet marrin masat e veta për t'i ofruar studentëve të ciklit të parë mbështetjen që u nevojitet, dhe gjatë vlerësimit, studentët u shprehën pozitivisht për mbështetjen e ofruar nga stafi akademik dhe ai i fakultetit. [RVV fq. 47; M4; M5; M6; M8] Rregulloret kanë dispozita për studentët që dështojnë në provime duke u ofruar atyre mundësi të japin provimet përsëri.[RVV fq. 47; AE37] Sipas Rregulloreve, Bordi i Etikës së Universitetit dhe fakulteti janë përgjegjës për administrimin e ankesave (shih pikën 4.3).[RVV fq. 47; AE37]
- 5.7 Statuti dhe Rregulloret e Universitetit përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e studentëve, së bashku me përcaktimet dhe financimin e Këshillave Studentorë në nivel Universiteti dhe fakulteti. [RVV fq. 48; AE37; FE 2] Këshillat studentorë zgjidhen çdo dy vjet dhe studentët janë të përfaqësuar në Këshillin e Fakultetit dhe në Senat. [M3] Universiteti siguron burime financiare për të mbështetur punën e Këshillit dhe studentët konfirmuan se ata kanë akses në këto burime [M3; M4]. Studentët e ciklit të parë dhe të dytë me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm folën pozitivisht për punën e Këshillit në organizimin e veprimtarive dhe në trajtimin e shqetësimeve, ndërkohë që studentët e ciklit të tretë kishin më pak dijeni për punën e tij. Ka prova të qarta që Universiteti i trajton çështjet e ngritura nga studentët. [RVV fq. 48; M3; M4; AE65]Megjithatë, Anketimi me Studentët tregoi se vetëm 31 përqind e studentëve mendojnë se vendim marrja është transparente dhe 63 përqind e studentëve nuk janë në dijeni të pjesëmarrjes studentore në mbledhjet e Senatit apo të Këshillave të Fakulteteve. [Anketimi me Studentët] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e nxit Universitetin që të identifikojë mënyra, për promovimin e punës së Këshillit Studentor dhe të përmirësojë transparencën e vendimmarrjes në Universitet.

- 5.8 Rregulloret e Universitetit përcaktojnë kuadrin e veprimtarive jashtëkurrikulare. **[AE37]** Universiteti promovon në mënyrë aktive mundësitë kulturore dhe shoqërore dhe në nivel fakulteti organizohen një sërë programesh dhe aktiviteteve që inkurajojnë pjesëmarrjen në jetën institucionale. Studentët që u takuan me grupin e vlerësimit ishin të kënaqur me mundësitë që ata kishin për t'u përfshirë në veprimtari kulturore dhe sportive. **[RVV fq. 48-49; M1; M4]** Qendrat e Karrierës organizojnë një program leksionesh dhe veprimtarish ekstra kurrikulare. **[AE18; AE19]** Në konviktet e studentëve funksionon një qendër shëndetësore, por Universiteti nuk ka të dhëna për shfrytëzimin e saj dhe në Anketimin me Studentët, 65 për qind e tyre e konsiderojnë ndihmën mjekësore si të dobët ose shumë të dobët. **[RVV fq. 49; AE67; Anketimi me Studentët]**
- 5.9 Universiteti kohët e fundit ka ngritur Qendra Karriere në fakultete, për të shërbyer si ura lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke vendosur kontakte me punëdhënës të mundshëm dhe duke promovuar kështu mundësitë studentëve për punësim. **[AE57; M1; M2; M5; M7]** Këto zyra identifikojnë mundësi praktikash dhe punësimi dhe ofrojnë tryeza pune javore dhe informacion lidhur me mobilitetin dhe bursat e studimit jashtë vendit. Ato organizojnë veprimtari si shkolla dimërore dhe verore, takime të hapura, leksione të hapura, një kampionat debati, panairë pune, udhëtime biznesi dhe takime të shkurtra me biznese. **[RVV fq. 45; AE17; M7]** Gjatë vlerësimit studentët folën pozitivisht për mundësitë e praktikave profesionale dhe grupi mori informacion mbi angazhimin e punëdhënësve për të mbështetur praktikantët dhe për punësimin e të diplomuarve. **[M2; M4; M5]** Megjithatë, në Anketimin me Studentët, 40 për qind e tyre u përgjigjën se informacioni mbi punësimin është i dobët ose shumë i dobët. Kjo pikëpamje u konfirmua gjatë takimit me studentët. **[Anketimi me Studentët; M4]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** veprimet e ndërmarra nga Universiteti për përmirësimin e mbështetjes për punësim përmes ngritjes së Qendrave të Karrierës. Fakulteti i Drejtësisë siguron prova të mbikëqyrjes së destinacioneve të punësimin të të diplomuarve, **[FE15; Dokumenti RVV 16]** por Universiteti aktualisht nuk përmbush kërkesën për mbajtjen e të dhënave statistikore për punësimin e të gjithë të diplomuarve të vet, **[M7; Dokumenti RVV 16; AE68; AE69]** dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si **dobësi**. Kështu Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të krijojë një strukturë dhe procedurë për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për punësimin e të diplomuarve të tij (deri në gusht të vitit 2018). **[Kapitulli I, Standardi III.9]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- ofrimin dhe aksesin e pamjaftueshëm lidhur me tekstet shkollore dhe materialet në internet (pika 5.5; **Kapitulli I, Standardi III.5**)
- mos ruajtjen e të dhënave statistikore për punësimin e të gjithë të diplomuarve (pika 5.9; **Kapitulli I, Standardi III.9**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti duhet të ndërmarrë që qasje sistematike për përmirësimin e aksesin në libra biblioteke dhe burime në internet (pika 5.5; **Kapitulli I, Standardi III.5**)
- Universiteti duhet të hartojë një politikë formale për shëndetin me procedura për vlerësimin e efikasitetit të saj (deri në gusht të vitit 2018) (pika 5.9; **Kapitulli I, Standardi III.9**).

Konfirmim i veprimeve që po ndërmerren

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se veprimet e mëposhtme po ndërmerren aktualisht:

- hapat e marrë nga Universiteti për të përmirësuar mbështetjen për punësim përmes ngritjes së Qendrave të Karrierës (pika 5.9; **Kapitulli I, Standardi III.9**).

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.